VENDIM
Nr. 78, datë 5.3.2018

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NDIHMË SHTETËRORE

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:
- Z. Arben Ahmetaj, kryetar;
- Znj. Mimoza Dhëmbi, anëtar;
- Z. Ahmet Mançellari, anëtar,

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 5.3.2018, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit"", mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për miratimin e ndihmës shtetërore të planifikuar për vitin 2018 për sh.a. "Trajtimi i studentëve" dhe në rrethe, në vlerën 350 milionë lekë.

I. Procedura

1. Me shkresën nr. 992, datë 31.1.2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë iu drejtua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Komisionit të Ndihmës Shtetërore) lidhur me kërkesën e sipërpërmendur, në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", të udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si edhe të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

II. Përshkrimi i masës

II.1 Baza ligjore e njoftimit

2. Në bazë të udhëzimit të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 2, datë 6.2.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, pika 86, është përcaktuar se Komisioni i Ndihmës Shtetërore miraton subvencionet që alokohen në bazë të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", si më poshtë:

"Për të gjitha llojet e subvencioneve zbatohen udhëzimet që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e tyre, të cilat ndryshojnë kur lind nevoja e përmirësimit të procedurave, rregullave apo afateve. Çelja e fondit të planifikuar për subvencion për vitin buxhetor do të kushtëzohet nga miratimi i këtij subvencioni nga komisioni i ndihmës shtetërore. Subvencioni nuk do të çelet pa marrë miratimin nga ky komision me përjashtim të subvencioneve për tekstet shkollore, shërbimet qeveritare".

3. Gjithashtu, ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, neni 17, "Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit", germa "a", përcakton se Komisioni i Ndihmës Shtetërore, mbi bazën e propozimeve të drejtorisë që mbulon çështjet e ndihmës shtetërore, vlerëson dhe autorizon skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale.

II.2 Masa e njoftuar e financimit

4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), në bazë të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", kërkon miratimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore të skemës së subvencionimit, për mbështetjen financiare/subvencionimin e "Trajtimi i studentëve" sh.a. në Tiranë dhe në rrethe, në vlerën 350 milionë lekë.

Në mënyrë më të detajuar ndërmarrjet përfituese nga skema e subvencionimit nga buxheti i shtetit janë:
1. Sh.a. "Rezidenca studentore" nr. 1, Tiranë;
2. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" nr. 2, Tiranë;
3. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" nr. 3, Tiranë;
4. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" Korçë;
5. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" Elbasan;
6. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" Shkodër;

7. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" Gjirokastër;

8. Sh.a. "Trajtimi i studentëve" Vlorë.

5. Nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR do të kalohet çdo muaj drejtpërdrejt në llogarinë e përfituesit shuma e planifikuar mujore sipas situatës financiare.

6. Sipas njoftimit të MASR-së, qëllimi i skemës së subvencionimit është mbështetja për krijimin e kushteve për akomodimin e studentëve nga shtresat sociale në nevojë. Gjithashtu raportohet se "Trajtimi i studentëve" sh.a. në Tiranë dhe në rrethe ka gjithsej 8551 studentë.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

7. Në bazë të njoftimit nga MASR-ja, Komisioni i Ndihmës Shtetërore e fillon analizën e tij duke kontrolluar nëse skema e subvencionimit për ndërmarrjet shtetërore të trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në rrethe, përbën ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, pra nëse skema ofron një avantazh ekonomik për ndërmarrje, të cilat kanë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare, që nuk do të ishte përfituar në kushte normale të tregut.

8. Neni 4, pika 1, e ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, përcakton se:

"Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdolloj forme e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara, për aq sa mund të ketë ndikim në plotësimin e detyrimeve të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, në marrëveshjet ndërkombëtare që përmbajnë dispozita të ndihmës shtetërore."

9. Gjithashtu, neni 71, "Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike", i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë[1], përcakton se:

"Praktikat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kritereve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit."

10. Sa më lart, ligji i ndihmës shtetërore zbatohet vetëm për masat që plotësojnë të gjitha kriteret e përmendura në nenin 4, pika 1, më konkretisht: a) burime shtetërore; b) avantazhi ekonomik; c) selektiviteti; dhe d) efekti në konkurrencë dhe treg.

11. Komisioni i Ndihmës Shtetërore shprehet se një nga objektivat themelorë të Traktatit të Krijimit të Komunitetit Evropian është respektimi i rregullave të ndihmës shtetërore për funksionimin e tregut të brendshëm dhe krijimi i një tregu të brendshëm të vetëm, në të cilin nuk cenohen kushtet për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në këtë treg[2]. Nëse dhënia e subvencioneve, granteve apo formave të tjera të trajtimit të favorshëm financiar për ndërmarrjet që ushtrojnë një aktivitet ekonomik, nuk i nënshtrohet një procesi vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Komisionit të Ndihmës Shtetërore[3], atëherë do të ekzistonte risku se këto "ndërmarrje" do të përfitonin një avantazh të padrejtë dhe do të ndikonin në konkurrencën efektive në treg, duke vepruar në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, të cilët nuk përfitojnë ndihmë shtetërore.

12. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), në bazë të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", kërkon miratimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore të skemës së subvencionimit për mbështetjen financiare të "Trajtimi i studentëve" sh.a. në Tiranë dhe në rrethe, duke aktivizuar burime

[1] Ligji nr. 9590, datë 27.7.2006, "Për ratifikimin e "Marrëveshjes së stabilizim-asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare"".

[2] Pjesa 2, "Ndihmat që jepen nga shtetet", neni 107 (ex article 87 TEC) i TFEU-së.

[3] Në zbatim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.

shtetërore në vlerën 350 milionë lekë.

Që një masë të përbëjë ndihmë shtetërore duhet që masa të ketë një ndikim të mundshëm në konkurrencë dhe tregtinë midis shteteve anëtare. Komisioni i Ndihmës Shtetërore e vlerëson këtë kriter vetëm nëse ekziston një treg konkurrues për ofrimin e shërbimit. Në njoftimin e MASR-së, konstatohet se skema e subvencionimit për "Trajtimi i studentëve" sh.a. Tiranë dhe në rrethe, jepet vetëm për ofrimin e shërbimit të krijimit të kushteve për akomodimin e studentëve nga shtresat sociale në nevojë nga ana e ndërmarrjeve shtetërore. Ky shërbim është i monopolizuar nga organet shtetërore, më konkretisht "Trajtimi i studentëve" sh.a., dhe ndërmarrjet e trajtimit të studentëve në rrethe, me statusin e shoqërive anonime 100%, me kapital shtetëror, në funksion të shtetit dhe politikat e tyre të administrimit kryhen me anë të vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës, anëtarët e të cilëve emërohen nga njësitë e qeverisjes qendrore.

Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore shprehet se ndërmarrjet "Trajtimi i studentëve" sh.a. në Tiranë dhe në rrethe, nuk veprojnë si ndërmarrje në kuptim të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, konkretisht të nenit 4, "Ndalimi i ndihmës shtetërore", pika 1, duke qenë se këto ndërmarrje ofrojnë shërbime publike dhe zënë pozitë monopol në këtë segment tregu dhe si të tilla mund të favorizohen padrejtësisht, për të konkurruar edhe në tregjet ndërkombëtare.

Meqenëse kriteret e përcaktuara në nenin 4, pika 1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar janë kumulative, Komisioni i Ndihmës Shtetërore arrin në konkluzionin se, financimi i ndërmarrjeve shtetërore të trajtimit të studentëve nuk përbën ndihmë shtetërore.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, pika 1, të nenit 17, 20, 22, dhe 31 të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Subvencioni i planifikuar në bazë të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", i destinuar për ndërmarrjet "Trajtimi i studentëve" sh.a. në Tiranë dhe në rrethe, në vlerën 350 milionë lekë, nuk përbën ndihmë shtetërore.
2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ahmetaj